

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Mirëmbajtja e Ambienteve të Brendshme dhe Taracës të OSHEE Group sh.a.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03121100-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,668,280 (gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhjetë e tete mijë e dyqind e tetëdhjetë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet te paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për te paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet te jete jo më e vogël se 1,333,600 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera 1,333,600 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind), është afersisht 20 % e fondit limit të përcaktuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe *parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 ”Per Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e përcaktuar ne udhezimin e Ministrisë të Financave ne zbatim te ketij Ligji.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 1,333,600 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) leke.

- a) Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje produktesh/shërbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të produkteve/shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymen e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 20 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license profesionale për realizimin e shërbimit objekt prokurimi të leshuar nga autoritetet kompetente shtetërore në kategorinë:

- a) License Kodi II.5.A.3 për “Prodhim dhe/ose tregëtim i produkteve të mbrojtjes së bimëve plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhanëve” leshuar nga QKL (e vlefshme);
- b) License Kodi II.4. për “Prodhim dhe/ose tregëtim i farave dhe/ose fidaneve” leshuar nga QKL (e vlefshme);

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Ligji Nr. 105, datë 27.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, VKM Nr. 335, datë 06.06.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, si dhe LIGJ Nr.10 416, datë 7.4.2011 dhe ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikate që verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësive se tij është në përputhje me ISO 9001-2015 objekti i secilës duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate ISO14001-2015 “per menaxhimin e mjedisit” objekti i seciles duhet te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Sqarim: certifikatat ISO ne gjuhe te huaj duhet te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen Shqipe, Keto certifikata duhet te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur ne Republiken e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhen plotesuar nga operatoret ekonomike sipas natyres se sherbimeve qe marrin persiper.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu, këto certifikata janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë dhe të menaxhimit të mjedisit me qellim garantimin qe shërbimi i ofruar do të realizohet sipas standarteve ndërkombëtare ISO.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar minimalisht 5 punonjes per muajin e Shtator 2023 e vertetuar kjo me :

- a) Vertetim te leshuar nga Administrata tatimore ku te specifikohet numer i punonjesve;
- b) Lispagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore sipas formatit E-sig.

2.3.6 Operatori ekonomik me qellim realizimin e ketij sherbimi, duhet te kete te punesuar e stafin e tij :

- a) 1 (nje) Agronom te pajisur diplome dhe kontrate pune.

2.3.7 Operatori ekonomik per te realizuar objektin e prokurimit duhet te kete te punesuar minimalisht 3 (tre) punonjes te certifikuar me certifikaten e kopshtarise.

Per stafin e mesiperme të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme pikat 4, 5 dhe 6 janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe në si dhe Ligji Nr. 105, datë 27.10.2016, "Për mbrojtjen e bimëve", VKM Nr. 335, datë 06.06.2018 "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve".

Sqarim: përmbushja e kërkesave 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: specifikimet teknike, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj", janë pjese ne DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Sqarim: Termat e references, preventivi, fondi limit dhe kriteret teknike janë hartuar sipas relacionin nr. 8028/2 prot., date 17.10.2023 te nga grupi i punes i perbere nga specialiste te fushes, te caktuar me urdher titullari nr. 8028/1 prot., date 16.10.2023.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga:

- | | |
|------------------|----------------------|
| • Valbona Kadëna | Përgjegjës prokurimi |
| • Denis Mekolli | Përgjegjës prokurimi |
| • Enkelejd Çopa | Përgjegjës prokurimi |